



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:007254
Datë: 01.10.2021
Numri i dokumentit: 02235662

C.nr.2072/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit, Besnik Shala, në çështjen juridike civile të procedurës kontestimore të paditëseve F.M, Z.M dhe D.M, të gjithë nga Peja, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga P kundër të paditurës KS.S ” zyra qendrore P, rr. “.....” nr....., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.M, me bazë juridike Zhdëmtim sipas auto-përgjegjesisë , vlera e kontestit 1,000 euro, jashtë seance me datë 22.01.2024, bie këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditëseve F.M, Z.M dhe D.M të gjithë nga P, kundër të paditurës KS.S ” zyra qendrore Prishtinë, rr. “.....” nr...., me bazë juridike Zhdëmtim sipas auto-përgjegjesisë , vlera e kontestit 1,000 euro.

A r s y e t i m

Paditësit për mes të autorizuarit të tyre pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kanë ushtruar padi me dt.13.08.2021, kundër të paditurës, me bazë juridike Zhdëmtim sipas auto-përgjegjesisë, vlera e kontestit 1,000 euro.

I autorizuari i paditësve me parashtresën e datës 13.12.2023, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, për shkak se me të njëjtën kemi arritur ujdj jashtëgjyqësore, andaj gjykata me dt.14.12.2023 e ka njoftuar palën e paditurën për tërheqjen e padisë së paditësit, ku e njëjta njoftimin e ka pranuar me datë 12.01.2024, dhe nuk është përgjigjur, andaj pasi që e paditura nuk është përgjigjur fare në njoftimi e gjykatës konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheq padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri

brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.22072/21 dt. 22.01.2024

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,
Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.